

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alinea 9 dhe neni 20 paragrafi 1 alinea 3 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20 dhe 77/21), dhe në pajtueshmëri me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr.02-342/5 nga 27.01.2022, miratuar në senacën e 3-të mbajtur më 27.01.2022, u përgatit Teksti i pastruar i rregullores për shfrytëzimin e celularëve zyrtar në Agjencin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Teksti i pastruar i Rregullores për shfrytëzimin e celularëve zyrtar në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale i përfshinë: Rregulloren për shfrytëzimin e celularëve zyrtar dhe modemit ZG USB të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Tekst I pastruar), nr.014045/1 nga 16.06.2015, Rregulloren, nr.01-1087/1 nga 23.02.2016, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shfrytëzimin e celularëve zyrtar dhe modemit ZG USB të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Tekst I pastruar), nr.01-4045/1 nga 16.06.2015 dhe Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për shfrytëzimin e celularëve zyrtar dhe modemit ZG USB të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, nr.01-388/1 nga 28.01.2022.

**RRGULLORE**  
**PËR PËRDORIMIN E TELEFONAVE ZYRTARË MOBIL NË AGJENCIN PËR SHËRBIME**  
**MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**(Tekst i pastruar)**

**Neni 1**

**Lënda**

Me këtë Rregullore rregullohet mënyra dhe kushtet e përdorimit të telefonit celular të cilat përfshijnë: të drejtën e përdorimit të celularit zyrtar, kufizimin e shumës së faturave dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me përdorimin e celularit zyrtar.

**Neni 2**

**E drejta për të përdorur celular zyrtar duke kufizuar shumën e faturës**

(1) Të drejtë e përdorimit të celularit zyrtar, duke kufizuar shumën e faturave deri në shumën e caktuar kanë:

- Kryetari i Këshillit dhe drejtori i Agjencisë: 4500,00 denarë;
- Zëvendëskryetari i Këshillit dhe zëvendësdrejtori i Agjencisë: 3.500,00 denarë;
- Anëtarët e Këshillit të Agjencisë: 2.500,00 denarë;
- Udhëheqësit e sektorëve dhe ndihmësit e udhëheqësve të sektorëve: 1.000,00 denarë;
- Udhëheqësit e reparteve dhe 500,00 denarë;
- Të punësuarit tjerë 250,00 денари.

(2) Në shumat e përmendura nga paragrafi (1) i këtij neni nuk përfshihen: tarifat mujore, roaming, tatami mbi vlerën e shtuar dhe shfrytëzimi i opsioneve bazë të ofruara nga operatori mobil.

(3) Tejkalimi i kufijve të lejuar të shumës së llogarive të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, deri në shumën e atyre shumave, miratohet me vendim të drejtorit të Agjencisë, kur është e lidhur me kryerjen e obligimeve zyrtare dhe detyrave të punës, kurse për drejtorin e Agjencisë miratohet me vendim nga ana e zëvendës drejtorit të Agjencisë, e në mungesë të tij kryetari i Këshillit të Agjencisë.

(4) Tejkalimi i kufijve të lejuar të shumës së llogarive të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, deri në shumën e atyre shumave, për shërbimin roaming, miratohet me vendim të drejtorit të Agjencisë, kur është e lidhur me kryerjen e obligimeve zyrtare dhe detyrave të punës, kurse për drejtorin e Agjencisë miratohet me vendim nga ana e zëvendës drejtorit të Agjencisë, e në mungesë të tij kryetari i Këshillit të Agjencisë.

(5) Me përjashtim, në bazë të vendimit të drejtorit të Agjencisë, miratohet tejkalimi i kufijve të lejuar të shumës së llogarive të përmendura në paragrafin (3) të këtij neni, dhe tejkalimi i kufirit për shërbimin roamin të përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, dhe për drejtorin e Agjencisë në bazë të vendimit të zëvendës drejtorit të Agjencisë dhe në rast mungesës së tij kryetari i Këshillit të Agjencisë.

(6) Përdoruesit e telefonave celularë zyrtarë që kanë tejkaluar kufizimet e lejuara, të përcaktuara në këtë nen të Rregullores, do t'u hiqen nga paga në shumën e diferencës ndërmjet kufirit të vendosur dhe shumës së faturës, për të cilën nënshkruajnë deklaratë kur pajisen me celular.

(7) Përdoruesit e celularit zyrtar të përcaktuar në këtë nen mund të pajisen vetëm me një SIM kartel dhe një celular zyrtar.

### **Neni 3**

#### **Të drejtën për të përdorur celular zyrtar me kufizim të shumës së llogarisë të punonjësve të tjerë në shërbimin profesional të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale**

(1) Të drejtën e përdorimit të celularit zyrtar me kufizim të shumës së llogarisë deri në një shumë të caktuar, do t'u njihet edhe të punësuarve të tjerë në njësitë organizative të shërbimit profesional të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

(2) Të drejtën e përdorimit të celularit zyrtar për personat nga paragrafi 1 i këtij neni kufizohet me shumën e parapagimit mujor.

(3) Tejkalimi i kufirit të lejuar të shumës së llogarive të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, deri në shumën e atij kufiri, miratohet me vendim të drejtorit të Agjencisë, kur ka të bëjë me kryerjen e obligimeve dhe detyrave zyrtare.

(4) Tejkalimi i kufirit të lejuar të shumës së llogarive të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, deri në shumën e atij kufiri, për shërbimin roaming, miratohet me vendim të drejtorit të Agjencisë, kur ka të bëjë me kryerjen e obligimeve dhe detyrave zyrtare të punës.

(5) Me përjashtim të tejkalimit të shumës së lejuar nga paragrafi 3 të këtij neni dhe tejkalimit të kufirit të roamingut të përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, me vendim të drejtorit të Agjencisë miratohet kur është lidhur me kryerjen e obligimeve dhe detyrave zyrtare.

(6) Përdoruesit e celularëve zyrtarë të cilët i kanë tejkaluar kufizimet e përcaktuara në paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni të rregullores, do t'u hiqen nga paga në lartësi deri në diferencën nga kufiri i përcaktuar së llogarisë për të cilën gjatë pajisjes me celular firmosin deklaratë.

(7) Përdoruesit e telefonit celular të përcaktuar në këtë nen mund të pajisen vetëm me një SIM kartelë dhe një celular zyrtarë.

### **Neni 4**

#### **Tjetërsimi dhe mënjanimi i celularit zyrtarë**

(1) Periudha e amortizimit të celularëve zyrtarë në pajtim me Rregulloren për kontabilitetin e buxhetit dhe shrytëzuesit buxhetor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr..28/03, 62/06, 8/09, 175/11 и 101/13), duke u nisur nga zhvillimi i shpejtë teknologjik i këtij lloji të pajisjeve, është 2 (dy) vjet.

(2) Çdo i punësuar i cili është pajisur me celular zyrtar është i obliguar të kujdeset për të dhe në rast të dëmtimit të tij mekanik është i detyruar me shpenzimet e veta ta sjellë atë në gjendje të rregullt dhe nuk ka të drejtë të kërkojë të ri për shkak të dëmtimit të celularit të dhënë më pare.

(3) Në rast të humbjes punonjësi është i detyruar të kompensojë diferencën në përputhje me amortizimin e përcaktuar të celularit zyrtar.

(4) Në rast të vjedhjes është e detyrueshme të dorëzohet raport policor dhe nëse shpjegimi është i arsyetuar, i punësuar nuk ngarkohet me vlerën kontabël, ndërsa me regjistrimin e mjeteve elementare do të çregjistrohet.

(5) Nëse në periudhën e amortizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni skadon koha për të cilën janë emëruar anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtorit të Agjencisë, zëvendës drejtorit të Agjencisë i skadon mandati ose ndërpritet marëdhënia e punës e të punësuarit në Agjencion. Personat janë të obliguar celularët zyrtarë të marrë me subvencion janë të detyruar t'i kthejnë në Sektorin për mbështetje informative dhe çështje të përgjithshme brenda 2 (dy) ditëve pune, në gjendje të mirë ose nëse vendosin t'i mbajnë, janë të detyruar t'i kthejnë në Agjencion dhe të njëjtit oblogohen të kompensojnë diferencën në përputhje me amortizimin e përcaktuar të celularit zyrtar të marrë me subvencion. Drejtori i Agjencisë merr vendim për ndërprerjen e celularit zyrtar pas pëlqimit paraprakisht të marrë nga Këshilli i Agjencisë.

(6) Pas skadimit të afatit të amortizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni , celularët zyrtarë të pranuar me subvencion do të mënjanohej me propzim të Komisionit të themeluar për atë qëllim për të cilin drejtori i Agjencisë do të sjellë vendim për mënjanimin e celularit zyrtar. Celularët e mënjeluar të marra me subvencion, mund t'u dorëzohen personave të cilët i kanë përdorur në bazë të kërkesës së dorëzuar dhe procesverbal të nënshkruar për dorëzim dhe të njëjtit do të çregjistrohen gjatë regjistrimit të mjeteve elementare.

(7) Celularët e mënjeluar mund të tjetërsohen si dhuratë për qëllime humanitare ose me shkatërrim.

## **Neni 5**

(Neni 5 i Rregullores për përdorimin e celularëve zyrtar dhe modemit ZG USB në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Tekst I pastruar), nr.01-862/1 nga 04.02.2015 )

## **Dispozitat përfundimtare**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja për përdorimin e celularëve zyrtarë në Këshillin e transmetuesëve të Republikës së Maqedonisë nr..01-3821/1 nga 12.07.2012.

Neni 3 i Rregullores nr.01-1087/1 nga 23.02.2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përdorimin e celularëve zyrtar dhe modemit ZG USB në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Tekst i pastruar), nr.01-4045/1 nga 16.06.2015)

Kjo Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përdorimin e celularëve zyrtar dhe modemit ZG USB në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Tekst i pastruar), nr.01-4045/1 nga 16.06.2015, hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e miratimit dhe do të publikohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

#### Neni 7

(Neni 7 i Rregullores, nr.01-388/1 nga 28.01.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shfrytëzimin e celularëve zyrtar dhe modemit ZG USB në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale )

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

**Agjencia për shërbime mediatike  
audio dhe audiovizuale  
Kryetar i Këshillit  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Nr.01-498/1**

**07-02—2022 Shkup**